

# atrc

Qendra e Trajnimeve & Burimeve për Avokim



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA

Perkrah

komunitetin e OJQ-ve



Vëllimi IV • Numri 7 • Gusht 2006

# AVOKUESI

## PËRMBAJTJA

### Faqe 1

Kryetari i Kosovës u bënë thirrje OJQ-ve të "mos përfshihen në politikë"

Mundësi financimi për OJQ: Agjencioni Evropian për Rindërtim bënë thirrje për projekt propozime për të forcuar rrjetet e shoqërisë civile në Kosovë

### Faqe 2

Të drejtat e njeriut duhet të dominojnë në bisedimet për statusin final të Kosovës, thotë Amnesty International

Flesh lajme për OJQ: Rrjeti i OJQ-ve Antikorruption reagon ndaj gjendjes së rëndë energjetike në Kosovë

Shpallje nga OJQ: Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ofron praktikë për studentë

**Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj**

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së: [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

## Kryetari i Kosovës u bënë thirrje OJQ-ve të "mos përfshihen në politikë"

ATRC-ja, në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të Kosovës, ka organizuar më 18 korrik tryezë të rrumbullakët në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës ndërmjet Kryetarit Fatmir Sejdiu dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Gjatë takimit, ata kanë diskutuar zhvillimet e fundit politike në Kosovë dhe mënyrat e mundshme të kontributit të shoqërisë civile.

"Në bazë të dëshmvive që kemi, plotësisht besoj se Kosova këtë vit do të jetë e pavarur, dhe marrëdhëniet me komunitetin ndërkombëtar do të jenë prioritet",

ka deklaruar Sejdiu.

Kryetari u ka bërë thirrje përfaqësuesve të OJQ-ve që të inicojnë "zhvillim dhe dinamik të re të proceseve të përgjithshme demokratike në Kosovë dhe të mos përfshihen në politikë".

"Mos u bëni pjesë e ndonjë lobimi politik ose instrument i ndonjë partie politike sepse mund ta



Tryeza e rrumbullakët ndërmjet Kryetarit të Kosovës Fatmir Sejdiu dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile më 18 korrik

humbni kualitetin që keni", ka shtuar Sejdiu.

Ky takim është realizuar në kuadër të një iniciative të ATRC-së, që synon afrimin e anëtarëve të ekipit negociator të statusit final të Kosovës me përfaqësues të shoqërisë civile.

## Mundësi financimi për OJQ

### Agjencioni Evropian për Rindërtim bënë thirrje për projekt propozime për të forcuar rrjetet e shoqërisë civile në Kosovë

Agjencioni Evropian për Rindërtim po kërkon projekt propozime për të përkrahur shoqatat e shoqërisë civile në Kosovë.

Ndihma financiare është siguruar nga CARDS Programi i Komuniteteve Evropiane.

Qëllimet kryesore të programit janë ngritja e kapacitetit të shoqatave të shoqërisë civile në formimin e partneriteteve dhe rrjeteve; përmirësimi i standardeve profesionale në favor të shërbimeve më të mira publike; dhe pjesëmarrja aktive në informimin, edukimin dhe aplikimin e çështjeve të BE-së.

Programi synon ngritjen e kapacitetit të shoqatave të

shoqërisë civile për të kontribuar në mënyrë të efektshme në transformimin dhe zhvillimin e strukturave ekonomike dhe qeverisëse duke afruar të gjitha komunitetet e Kosovës më



Një seancë informimi për kërkesën për projekt propozime do të mbahet më 12 shtator, 2006 në orën 10:30 në zyrat e Agjencionit Evropian për Rindërtim, Prishtinë

pranë standardeve evropiane.

Organizatrat ndërkombëtare, OJQ-të dhe shoqatat e shoqërisë civile janë të ftuara që propozimet e tyre t'i adresojnë qëllimet dhe prioritetet e programit.

Përshkrimi i plotë i programit ofrohet nga Udhëzuesi për Grant Aplikantët.

Aplikantët mund ta sigurojnë Udhëzuesin për Grant Aplikantët në njërin prej këtyre faqeve të internetit: <http://ec.europa.eu/comm/europeaid/tender/gestion/index.htm>, ose <http://www.eur.eu.int/projects/projects.htm>

Afati i fundit i dorëzimit të propozimeve është 3 nëntori, 2006.

**atrc**

**Drejtoreshë Ekzekutive**  
RREZE DULI  
rreze@advocacy-center.org

**Menaxher i Financave & Administratës**  
GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org

**Trajnere & Konsultante**  
DONIKA SALIHU  
donika@advocacy-center.org

**Trajnere & Konsultante**  
AFERDITA SURROI  
aferdita@advocacy-center.org

**Trajner & Konsultant**  
KUSHTRIM ISLAMI  
kushtrim@advocacy-center.org

**Menaxhere për Komunikim & Ndërlidhje**  
ARJETA DOROCI  
arjeta@advocacy-center.org

**Bashkëpunëtore e Programit**  
NATYRA ZHJEQI  
natyra@advocacy-center.org

**Menaxher për IT dhe Database**  
ARSIM KOSUMI  
arsim@advocacy-center.org

**Rr. Agim Ramadani Nr. 15**  
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë  
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244 810

## Të drejtat e njeriut duhet të dominojnë në bisedimet për statusin final të Kosovës, thotë Amnesty International

"Derisa bisedimet për përcaktimin e statusit final të Kosovës po vazhdojnë në Vjenë, Amnesty International u bënë thirrje pjesëmarrësve që të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të gjithë personave në Kosovë gjatë këtij procesi, dhe të drejtat e njeriut të adresohen në secilën fazë dhe në të gjitha aspektet e bisedimeve", thuhet në një njoftim për media të publikuar nga Amnesty International më 24 korrik.

Në një dokument dërguar të gjithë pjesëmarrësve në

bisedime, Amnesty International ka ofruar një sërë rekomandimesh për të siguruar se promovimi, mbrojtja dhe përmbushja e të drejtave të njeriut janë të garantuara me cilëndo deklaratë finale. Organizata beson se pavarësisht statusit final të Kosovës, të drejtat e njeriut të të gjithë qytetarëve duhet të respektohen, mbrohen dhe përmbushen dhe se të gjithë ata që janë në pozita të larta në nivel vendor dhe ndërkombëtar duhet të jenë përgjegjës për veprimet e tyre.

"Pjesëmarrja dhe përfshirja e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë minoritetet siç janë romët, ashkalitë, egjiptianët, boshnjakët, goranët, dhe turqit, po ashtu edhe organizatat e grave, duhet t'u garantohet se të drejtat e tyre janë po ashtu të përfshira në deklaratën finale", ka pohuar Sian Jones, hulumtues i Amnesty International në Kosovë.

*Tekstin e plotë të komunikatës për media të Amnesty International mund ta lexoni në <http://news.amnesty.org/index/ENGEUR700092006>.*

### Flesh lajme për OJQ

## Rrjeti i OJQ-ve Antikorrupsion reagon ndaj gjendjes së rëndë energjetike në Kosovë

Përmes një letre të hapur për qytetarët dhe parlamentin e Kosovës, "Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet - Çohu" dhe Rrjeti i OJQ-ve Antikorrupsion kanë reaguar më 3 gusht ndaj gjendjes së rëndë të furnizimit me energji elektrike në Kosovë, si dhe ndaj problemeve të tjera

të jetës publike. Bashkë me reagimin është shpërndarë po ashtu një listë me emrat dhe kualifikimet e anëtarëve të kabinetit qeverisës të Kosovës për të treguar se sa kompetent dhe profesionist është ky kabinet për punën që bënë.

*Letrën e plotë mund ta lexoni në <http://www.cohu.org/Keku.htm>*



### Shpallje nga OJQ

## Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ofron praktikë për studentë

Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) në Prishtinë ka ofruar praktikë për periudhën gusht-tetor 2006 për studentë dhe të sapo diplomuar.

Praktikantët do të fitojnë përvojë pune gjatë angazhimit në YIHR, do të përfshihen në një sërë aktiviteteve

derisa kontribuojnë në punët e përgjithshme në zyrë. Përmes punës së tyre, praktikantët do të kenë mundësi të fitojnë njohuri për të drejtat e njeriut dhe çështjet e avokimit; fitojnë dhe praktikojnë njohuritë e fituara gjatë studimeve ose karrierës së tyre; dhe të kenë mundësi të

marrin pjesë në ngjarje të ndryshme dhe të krijojnë kontakte të reja.

*Për përshkrimin e kërkesave të përgjithshme, detyrave dhe përgjegjësisve, kohëzgjatjen e praktikave dhe udhëzimit për aplikim, kontakttoni 038 244 517 ose [ksoffice@yih.org](mailto:ksoffice@yih.org)*

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.